



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për mediat

Për seancën dëgjimore me shoqërinë Classic Wolkswagen për raportin “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të automjeteve të reja”

Tiranë, 23.06.2010 - Në përfundim të raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të automjeteve të reja” dhe në zbatim të procedurave që parashikon Ligji nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sot në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë Classic Wolkswagen, palë nën hetim.

Pikat kryesore të diskutimeve u përqendruan në sjelljet e kësaj ndërmarrjeje në kuadër të paraqitjes së ofertave për procedurat e prokurimit të automjeteve të reja dhe mundësisë së bashkëpunimit me ndërmarrje të tjera në këtë treg.

Përfaqësuesit e Classic Wolkswagen paraqiten argumentet e tyre në lidhje me këto çështje dhe pretendimet kundrejt konkluzioneve të raportit përfundimtar se kjo kompani nuk ka bashkëpunuar dhe nuk bashkëpunon me ndërmarrje të tjera për të koordinuar veprimtarinë e tyre në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja.

Me përfundimin e seancave dëgjimore dhe vënien në dispozicion të të gjithë informacionit të nevojshëm, Komisioni i Konkurrencës do të marrë një vendim përfundimtar bazuar në raportin “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të automjeteve të reja” si dhe të seancave dëgjimore të organizuara.